



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHETËRËOR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

**Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit:**  
Komuna e Studeniçanit

**Lënda e revizionit:**

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë të llogarisë së buxhetit themelor (637) për vitin 2020

**Qëllimi i revizionit:**

Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore

**Gjendjet kyçe të konstatuara:**

- Zbatimi jokonsekuent i Ligjit për ndërtimin e ndërtimeve në të cilat investitor është komuna;
- Shpenzime në vlerë prej 2.403 mijë denarë pa dokument mbështetës përkatës;
- Dobësi në regjistrimin dhe evidentimin joadekuat të mjeteve materiale;
- Është lidhë marrëveshje kornizë në vlerë prej 18.880 mijë denarë, edhe pse KSHAPP ka miratuar Aktvendim për anulimin e procedurës.

**Mendimi i dhënë/përfundimi \*:**



Revizioni nuk shpreh mendim për të vertetën dhe objektivitetin e raporteve financiare për vitin 2020, ndërsa për pajtueshmërinë e veprimtarive dhe transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante shpreh mendim të pavolitshtëm.

**Rekomandimet kyçe:**

- Sigurimi i dokumentacionit të kompletuar për punët ndërtimore të kryera, që duhet të jetë pjesë plotësuese e secilit projekt investues;
- Ndryshimet në librat afariste të jenë në bazë të dokumentacioneve të kontabilitetit të besueshëm dhe të kompletuar;
- Vendosjen e evidencës materiale dhe të kryet regjistrimi gjithëpërfshirës dhe pajtueshmëria e evidencës së kontabilitetit me gjendjen faktike;
- Të respektohen vendimet e KSHAPP.

**Dobësitë kyçe të sistemit:**

/

**Vërejtjet e marra të draft-raportit:**

Nuk janë marrë vërejtje për draft-raportin e llogarisë së buxhetit themelor (637) për vitin 2020.

**Përgjigjet e vërejtjeve të marra:**

/

\* pozitive, me rezervë, të pavolitshtëm, të përmbajtur